

PROGRAMI ZGJEDHOR KANDIDATIT PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË TETOVËS

BASHKË...

3

*për Komunën
që duam!*



www.bdi.mk

**PROGRAMI ZGJEDHOR I
KANDIDATIT PËR KRYETAR TË
KOMUNËS SË TETOVËS**



PËR TETOVËN QË DUAM

Tetor, 2017



për Komunën që duam!



PËRMBAJTJE

Mesazhi i kandidatës për kryetare të Komunës së Tetovës

Demokracia lokale dhe qeverisja e mirë

Barazia gjinore

Zhvillimi ekonomik lokal

Zhvillimi i qëndrueshëm urban

Sistemi GIS

Infrastruktura rrugore, parkimi dhe transporti Ndriçimi

publik

Gazifikimi i komunës së Tetovës

Trajtimi i ujërave të zeza dhe rrjeti i kanalizimit Rrjeti i

ujësjellsit

Zhvillimi i qëndrueshëm rural dhe turizmi malor Arsimi,

kultura dhe rinia

Mjedisi i pastër jetësor

Mbrojtja sociale

MESAZHI I KANDIDATES PËR KRYETARE TË KOMUNËS SË TETOVËS

Tetor 2017, Qytetarë të nderuar,

Para katër vitesh ju përkrahët vizionin për Tetovën si qytet me zhvillim të qëndrueshëm urban dhe rural, me infrastrukturë efikase rrugore, linja të rregullta të transportit publik, komunikacion të rregullt, ambient të pastër jetësor me parqe të gjelbëruese që ruhen e mirëmbahen. Ne premtuam që Tetova do të jetë qendër e jetës së pasur kulturore, arsimore dhe sportive me bibliotekë qyteti, teatër, kinema, muze dhe hapësira të posaçme për rekreacion dhe argëtim, qytet i njohur për zhvillimin ekonomik, fuqinë intelektuale dhe financiare, e integruar në zhvillimet rajonale dhe ndërkombëtare me jetë cilësore për të gjithë qytetarët. Sepse Tetova meriton ndryshe! Ju votuat për një vizion afatgjatë, sepse transformimi i Tetovës nga një qytet që ka funksionuar në kaos për dekada të tëra në qytet funksional bashkëkohor dhe paralelisht transformimi i institucionit komunë nga një strofull që i shërben interesave vetjake dhe grupe të udhëheqësve të saj në institucion që orienton politikat e saja në drejtim të zhvillimit shumë dimensional të qytetit, është i pamundur të ndodh për katër vite. Ne filluam një rrugëtim të ri për Tetovën, rrugëtim në të cilin asnjë interes përveç interesit të qytetarëve të Tetovës nuk ishte udhërrëfyes për angazhimin dhe veprimin tonë. Vendosija e këtij parimi dhe qëndrimi pas tij, nën kushtet aktuale nuk ka qenë aspak e lehtë mirëpo ia ka vlejtur sepse pikërisht ky parim është pikënisje për një drejtim në të cilin duhet të punohet jo në vitet e kaluara po në dekadat e ardhshme. Ne morëm përsipër të zgjedhim probleme të mëdha të grumbulluara me dekada të tëra, probleme këto që kanë shëmtuar fizionominë e qytetit dhe konceptin mendor për qytetin. Ne nuk pretendojmë se i kemi zgjedhur të gjitha problemet e Tetovës për katër vite por me plot bindje themi që kemi punuar me tërë kapacitetin njerëzor, intelektual dhe financiar në zgjedhjen e tyre dhe kemi krijuar një kulturë të punës së ndershme të institucionit për të mirën e qytetarëve. Katër vitet e fundit lidhjet, librezat partiake, pushteti që del nga çajtoret e mëhallës dhe veçanërisht korrupsioni dhe ryshfeti kanë pushuar së qeni praktikë e zakonit e të “kryerit punë në komunë”. Ne kemi qenë në shërbimin tuaj për të kryer punët nga kompetencat tona dhe për t’ju plotësuar nevojat dhe

kërkesat tuaja të cilat janë në përputhje me ligjin mirëpo çdo kërkesë që nuk ka qenë në përputhje me aktet ligjore është refuzuar. Pavarësisht shumës së rryshfetit që dikush ka ofruar ose pozitës së zyrtarit të komunës që ka intervenuar për plotësimin e saj, kërkesa e paligjshme gjithmonë është refuzuar. Vendosija e rendit dhe rregullit nuk e ka bërë komunën e Tetovës të vështirë për të bashkëpunuar por e ka bërë profesionale dhe përfundimisht të vetëdijshme për rolin e vet në mbrojtjen e interesave të qytetarëve të saj. Politikat dhe veprimtaria jonë ka qenë e orientuar vetëm kah plotësimi i nevojave të qytetarëve dhe nevojave zhvillimore të qytetit në shekullin ku ndodhemi.

Qytetarë të dashur, para katër vitesh, uji i pijshëm ishte një premtim parazgjedhor i yni, njëjtë sikur ka qenë premtim i të gjithë kandidatëve për kryetarë të Tetovës gjashtëmbëdhjetë vitet e kaluara. Gjatë këtyre viteve të gjithë kemi qenë të vetëdijshëm që uji është e drejtë themelore njerëzore që duhet ta gëzojë çdo tetovar por ajo që na dalloj neve nga bashkëmendimtarët në këto vite është fakti që ne investuam tërë kapacitetin administrativ intelektual dhe financiar në përmbylljen e këtij problemi mesjetar. Ne punuam me përkushtim dhe nder! Për dy fazat e ndërtimit dhe vënies në funksion të sistemit të ujësjellësit nga pushteti qendror u ndanë 4.5 milion euro. Nga 11 km të ndërtuara brenda gjashtëmbëdhjetë vitesh prej kur është iniciuar ky projekt, për katër vite ne përfunduam 8.5 km të mbetura nga gypi i ujësjellësit, sanuam një pjesë të konsiderueshme nga gjatësia e gypit i cili ishte i dëmtuar dhe vjedhur, aplikua me projekt për stacionin e pastrimit të ujit në Bankën Evropiane për Zhvillim, fituam grant prej 1.6 milion euro dhe përfunduam projektin. Si pasojë ju qytetarë të nderuar prej tash e tutje do të keni rregullisht ujë të pijshëm në çezmat tuaja ndërsa ne mund të shprehim vetëm keqardhje që në këtë shekull për gati se dy dekada jemi ballafaquar me mungesë uji.

Ne jemi të bashkuar në qëllimin tonë tu shërbejmë qytetarëve dhe ta përparojmë qytetin tonë duke përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve të Tetovës dhe në këtë qëllim kemi pasur sukses gjithmonë duke pasur parasysh që sukcesi është proces dhe energji e vazhdueshme e shfrytëzuar për ti ec proceset përpara pavarësisht kushteve dhe rrethanave ku gjendemi.

Gjatë periudhës së kaluar ku kemi dhënë maksimumin tonë për të zgjedhur problemin e mungesës së ujit në qytet ne u ballafaquam edhe me ndotje enorme të ajrit si pasojë e fabrikës Jugokrom në komunën e Jegunovcës e cila punonte pa filtra mbrojtës por falë aktivizmit qytetar dhe presionit politik dhe institucional

ky problem u zgjodh. Para dy vitesh rajonin e Tetovës e kapluan vërshime të rënda ku tragjedia më e madhe ishte humbja e jetëve njerëzore. Si komunë, ne morëm përgjegjësitë që na takojnë dhe besoj që ishim në krye të detyrës sepse 24 orë kemi qenë të angazhuar në terren për ta normalizuar situatën në vendet e vërshuara megjithatë këtë sfidë kurrë nuk do të kishim mundur ta tejkalojmë me sukses pa koordinimin dhe bashkëpunimin me institucionet qendrore dhe solidaritetin treguar nga biznesmenët tetovarë, ndërmarrjet dhe komunat e ndryshme anë e kënd Maqedonisë, ambasadat dhe organizatat e huaja në vend, qeverinë e Shqipërisë dhe Kosovës, dhe të gjithë qytetarët që ndihmuan në përmbylljen e këtij kapitulli të dhimbshëm.

Në katër vite mandat, me 8 milion euro borxh të trashëguar nga komuna e Tetovës, 4 milion euro borxh ndaj ndërmarrjeve që kanë transportuar nxënësit në shkolla, Ndërmarrje publike komunale gati të falimentuar, dy procese zgjedhore gjatë të cilave gjashtë muaj kemi qenë të ndaluar me ligj të shpallim thirrje për furnizime publike të cilat janë të domosdoshme për realizimin e projekteve të parapara për vitin buxhetor, ne arritëm të shtrojmë 20 km asfalt në infrastrukturën e dërmuar rrugore në zonat urbane dhe rurale, për të vënë rregull në komunikacionin kaotik themeluan Ndërmarrjen publike për menaxhim, ndërtim dhe mirëmbajtje me hapësirat për parkim, rindërtuam bulevardin Iliria dhe jemi duke i shtruar trotualet përreth bulevardit kryesor, pastruam deponinë e egër dhe filluam ndërtimin e stacionit për ngarkim dhe shkarkim të mbeturinave, filluam projektin për rrugën e Banjës që do të jetë një zonë rekreimi për qytetarët e Tetovës, rregulluam Parkun e Gruas përballë qendrës sportive dhe dhjetëra projekte tjera detajet e të cilave do ti lexoni në programin në vijim së bashku me projektet të cilat janë në zbatim e sipër dhe tjera që i kemi paraparë për katërvjeçarin e ardhshëm.

Qytetarë të nderuar, ne jemi larg nga Tetova që dëshirojmë ta kemi por jemi në drejtimin e duhur për ta realizuar vizionin për një Tetovë ndryshe, vizion ky që me përkrahjen tuaj premtojmë se do të vazhdojmë ta realizojmë me integritet, sinqeritet dhe përkushtim. Ju ftoj ta lexoni programin në vijim i cili përmban informata për aktivitetet e ndërmarra dhe projektet e planifikuara për katër vitet e ardhshme që do ti shërbejnë realizimit të vizionit tonë të përbashkët për Tetovën.

DEMOKRACIA LOKALE DHE QEVERISJA E MIRË

Njëri nga synimet kryesore të politikave të komunës ka qenë jetësimi i demokracisë lokale në funksionimin e saj përmes vendosjes së parimit të transparencës, përgjegjshmërisë, llogaridhënies. Qeverisja e mirë është përbërës themelor i zhvillimit të një demokracie të shëndoshë lokale prandaj kemi aplikuar politika për çlirimin e institucionit komunë dhe ndërmarrjeve publike nga ndikimet politike, klientelizmi, praktikat e korrupsionit dhe interesat e grupeve të biznesit dhe përmirësimi i shërbimeve që ju ofrohen qytetarëve të komunës së Tetovës. Në këtë drejtim komuna ka ndërmarrë veprime për riorganizimin efektiv të administratës së komunës, vendosjen e sistemit të integritetit, ngritjen e kapaciteteve të saj dhe ofrimin e zgjedhjeve inovative për lehtësimin e punës së administratës dhe qasjes së qytetarëve në shërbimet që i ofron komuna sipas kompetencave të saja ligjore në fazën e dytë të decentralizimit. Katër vitet e kaluara komuna e Tetovës është angazhuar në ngritjen e kapaciteteve të resurseve njerëzore përmes pjesëmarrjes në trajnimet e rregullta të cilat i ka organizuar Bashkësia e njëjësive të vetëqeverisjes lokale si dhe në trajnime ndërkombëtare dhe projekte për shkëmbimin e përvojave si që janë: Transparencë dhe llogaridhënie në shërbimet komunale - International Visitors Leadership Program, TAIEX - Instrumenti i asistencës teknike dhe këmbimit të informative të Komisionit Evropian, programi MATRA, i financuar nga Ministria e punëve të jashtme e Mbretërisë së Holandës, trajnimet e qendrës ndërkombëtare për demokraci lokale ICLD në Suedi POWER: Rrjeti Evropian i grave kryetare komunash për mundësi të barabarta në jetën e qytetarëve, Unioni i bashkive shqiptare i themeluar nga bashkia e Tiranës.

Në drejtim të ndryshimit të praktikës së mungesës së transparencës dhe llogaridhënies është forcuar roli i Zyrës për marrëdhënie me publikun e cila ka qenë e obliguar që rregullisht përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit direkt dhe indirekt të ndajë informata për punën dhe veprimet e komunës. Kryetarja e komunës ka praktikuar informimin vjetor të këshillit dhe publikut për raportet vjetore të punës dhe ndërhyrjet investive të komunës dhe ka realizuar takime të drejtpërdrejta me qytetarët në ditë dhe orë të caktuara.

Për të ngritur cilësinë e shërbimeve komunale është aplikuar koncepti i evidentimit të vetëm të dhënave – koncepti i komunës digjitale ku janë zhvilluar dhe aplikuar këto aplikacione/softuer:

- Arkiva elektronike
- Regjistri për procedurën e përgjithshme
- Regjistri për ankesa dhe propozime
- Prokurimet publike dhe ndjekja e kontratave
- Regjistri për procedurën e përgjithshme të inspektoratit
- Transporti rrugor

Aplikacioni e-report është krijuar që qytetarët në çdo kohë të mund t'i paraqesin sjelljet e pandërgjegjshme të personave fizik dhe juridik të cilët me veprimet e tyre ndotin ambientin jetësor në numrin 0800 55 043 dhe njëkohësisht të marrin informata kthyesë në lidhje me statusin e rasteve të paraqitura si rezultat i reagimit të inspektorëve ekologjik. Nga vendosja e këtij aplikacioni nga ana e inspektorëve ekologjik janë pranuar dhe trajtuar 50 paraqitje qytetarësh.

Sistemi i informacionit e-lege për ndërtim mundëson udhëheqjen e procedurave në të gjitha fazat e saj vetëm në mënyrë elektronike. Për çdo fazë në të cilën gjendet lënda e qytetarit, ai/ajo do të njoftohet automatikisht nëpërmjet sistemit të pavarur të ofrimit të postës dhe njoftimeve automatike dërguar përmes Short Message Service.

Disa sisteme që parashohin menaxhimin me informatën dhe dokumentet, tani më janë në përdorim, dhe këtu po përmendim: e-TaxTourism, Arkiva elektronike, sistemi për dhënien e lejeve të ndërtimit - sistem i Ministrisë për transport dhe lidhje. Në mandatin e ardhshëm parashihet implementim i plotë i sistemeve ekzistuese, rikonstruimi i disa sistemeve të tjera të ngjashme, siç janë e-Inspektorati, e-Njoftime, etj., si dhe integrimi i tyre në sistem të vetëm - One Stop Shop- të qasshëm në çdo kohë dhe pavarësisht vendit. Vlera e projektit është 1.2 milion euro ndërsa i njëjti parashihet të zbatohet nga 2014-2023.

Me vënien në përdorim të plotë të sistemit DMS ((Document management system) do të mundësohet ndjekja dhe ruajtja e dokumenteve në formë elektronike, miratimi i përpiktë dhe arkivimi i tyre. Çdo i punësuar ka privilegjet e paracaktuara sipas sistematizimit horizontal dhe vertikal, si dhe nënshkrimin elektronik.



Në këtë mënyrë menaxhmenti gjithmonë e di vend-ndodhjen e çdo dokumenti në organizatë dhe arsyet eventuale për ngecje dhe vonesa.

Në mandatin e ardhshëm, me qëllim të ngritjes së transparencës dhe rritjes së efikasitetit të administratës komunale, planifikohet të bëhet digjitalizimi me i avancuar i shërbimeve komunale përmes aplikimit të disa zgjidhjeve softuerike :

1. WEB GIS - aplikacion për gjenerim automatik të certifikatave nga plani. Ky aplikacion për më pak se një minutë do mund të gjenerojë certifikatë nga plani bashkë me të dhënat e planit sintez, komunal dhe infrastrukturor.
2. Digjitalizimi i të gjitha planeve urbanistike dhe parcelave ndërtimore/urbanistike në Komunën e Tetovës. Nëpërmjet GIS sistemit në mënyrë transparente dhe të qartë do të publikohen informacionet për lartësitë maksimale të lejuara për ndërtim, koeficientet e shfrytëzimit të tokës, destinimi i parcelave, kushtet e ndërtimit etj.

3. Projekt për evidentimin e të gjitha entiteteve afariste dhe institucioneve ekzistuese në komunën e Tetovës, përmes së cilit qytetarët do të kenë mundësinë t'i kërkojnë, të gjejnë lokacionin e tyre dhe më lehtë t'i kontaktojnë. Regjistri afarist do të shërbejë edhe për promovimin e potencialeve për investim në komunë me çka çdo qytetar ose investitor i interesuar me të vetmin pozicionim në hartë do fitojë analizë hapësinore dhe informacion për largësinë e çdo tipi të biznesit ose institucionit.

4. Projekt për paraqitje 3D dhe krahasim të parcelave ndërtimore në komunën e Tetovës. Me këtë projekt në mënyrë bashkëkohore përmes portalit komunal GIS, do të përpunohet web tregues vizual për parcelat momentale ndërtimore, si dhe do të bëhet krahasim me parcelat ndërtimore të planifikuara. Me treguesin 3D, çdo qytetar dhe investitor i interesuar do të mund më lehtë të parashih pamjen e ardhshme të mjedisit të tij.

5. Projekt për Android aplikacion për celularë "Plani im", përmes të cilit do të fitohen informacione për parcelat ndërtimore. Me projektin do të përpilohet android aplikacion për celularë, të cilin çdo qytetar i interesuar mund ta instalojë në smartphone-in e tij dhe në varësi të vendndodhjes së tyre do të mund të merr informacione mbi lartësinë maksimale të lejuar për ndërtim, koeficientin e qëndrueshmërisë së tokës, destinimin e parcelave, kushtet për ndërtim, etj, për çdo parcelë veçmas. Me këtë projekt, komuna në mënyrë bashkëkohore, përmes aplikacionit android do t'ju mundësojë qytetarëve të dhëna urbanistike për parcelat ndërtimore.

6. Projekt për miratim më transparent të planeve urbanistike në fazën e anketave publike duke bërë krahasim midis parcelave të reja dhe të vjetra. Kur firma që bën planifikimin, do të dorëzojë propozim planin urbanistik për rishqyrtim në komunë, përmes aplikacionit të posaçëm për analizë, do të bëhet krahasimi i parcelave të reja urbanistike të planifikuara me parcelat ndërtimore ekzistuese, me çka do të fitohet raport i detajuar dhe përmbledhës për çdo parcelë ndërtimore. Me këtë projekt, të punësuarit do të mund të ndjekin zhvillimin urban komunal, dhe do të mund t'ju përgjigjen qytetarëve të interesuar në mënyrë të shpejtë dhe transparente për ndryshimet në planin e ri dhe të vjetër urbanistik.

7. Projekt për inventarizimin e pajisjeve urbane ne komunën e Tetovës. Me këtë projekt planifikohet të nënshkruhet bashkëpunim me fakultetet teknike vendore, përmes të cilit studentet përpara diplomimit të mund të kryejnë punën praktike (pjesë e domosdoshme e studimeve të tyre) si dhe të dalin në teren në të gjithë territorin e komunës së Tetovës, ku do të mund të grumbullojnë lokacionet, informacionet për pajisjet urbane që janë në pronësi të komunës. Për këtë qëllim, komuna do të bëjë android aplikacion përmes të cilit në mënyrë të thjeshtë do të mund të grumbullohen lokacionet dhe informacionet për: banka, kandilabra ndriçuese, shporta mbeturinash dhe kontejnerë, etj. Të njëjtat do të publikohen në portalin komunal të GIS-it përmes të cilit komuna dhe qytetarët njëkohësisht do të mund të ndjekin investimet dhe situatën momentale.

8. Projekt për hartim dhe inventarizim të infrastrukturës të ujësjellësit dhe kanalizimit në Ndërmarrjen publike për ujësjellës dhe kanalizim, Tetovë. Me këtë projekt, planifikohet të mblidhen të gjitha të dhënat për infrastrukturën nëntokësore të ujësjellësit dhe kanalizimit në ndërmarrjen publike dhe të njëjtat të integrohen në GIS aplikacionin, si dhe të inventarizohen të gjitha elementet në rrjet dhe shfrytëzuesit e fundit. Me këtë projekt do të rritet efikasiteti i NP dhe po ashtu më lehtë do të planifikohet zhvillimi i rrjetit dhe mirëmbajtja dhe menaxhimi i defekteve.

Me qëllim të qasjes më të lehtë ndaj shërbimeve që ofron komuna, do të vendoset këndi i informacionit i cili do të mundësojë qytetarit adresimin e cilës do të kërkesë apo çështje në një sportel të vetëm fizik. Te punësuarit në këtë sportel do të kenë për obligim ta informojnë, orientojnë dhe ndihmojnë qytetarin për të realizuar kërkesën apo nevojën e tij. Po ashtu në këtë hapësirë do të vendoset EU info qendra, e cila do ofrojë shërbime informuese për funksionimin e Unionit Evropian, institucionet dhe programet që ata i ofrojnë për qytetarët e komunës së Tetovës.

Tetova Smart City është një iniciativë e komunës së Tetovës dhe VETRON SHPK si një hap më para drejt modernizimit të jetës së qytetarëve dhe lehtësimit të komunikimit të qytetarëve dhe vizitorëve. Në kuadër të projektit në hapësirat urbane do të vendoset rrjet i pajisjeve më bashkëkohore të tipit Vendotel të cilat mundësojnë një numër të madh të shërbimeve dhe produkteve digjitale.

Me infrastrukturën digjitale për një qytet të mençur Tetova u bashkëngjitet

qyteteve më të përparuara të cilat u mundësojnë qytetarëve të tyre shërbime digjitale në hapësirat e tyre urbane duke lehtësuar në këtë mënyrë përditshmërinë e tyre dhe duke i dhënë një kahje të re përparimit të qytetit.

Shërbimet që do jenë të ofruara nga ky rrjet i pajisjeve digjitale janë: qasje në Wi-Fi, blerja e biletave për parkim, pagesa e llogarive, shërbime kadastrale, komunikim me qytetarët dhe shërbime tjera digjitale.

Specifikacioni i pajisjes:

Funksionaliteti

Ekran 24" i ndjeshëm në prekje

Dëgjuese telefonike

Tastaturë numerike

Printer industrial

Dy kamera

Senzor për afërsi të shfrytëzuesit

Sistem për menaxhim me para, kartela kreditore

Lexues të barkodit

Wi-fi përcjellës

Kompjutor i integruar

Të dhëna fizike

Pesha: 60kg

LxGJxTH: 100x50x40 cm

Vendosja: Në mur ose në shtyllë

Përpunimi: Material jokoroziv, i qëndrueshëm ndaj kushteve klimatike

BARAZIA GJINORE

Barazia gjinore është parakusht për zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor të një shoqërie. Shoqëritë nuk mund të përparojnë pa kultivuar ndjenjën e barazisë mes dy gjinive. Femrat dhe meshkujt janë të lindur të barabartë dhe si të tillë duhet të kenë mundësitë e njëjta për zhvillim individual e në këtë mënyrë të kontribuojnë në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë. Komuna e Tetovës angazhohet në vazhdimësi të integrojë perspektivën gjinore në politika saja në sferën e punësimit, edukimit, kulturës, sportit si dhe të ndikojë në përfshirjen sa më të madhe të grave dhe femrave në procesin e përparimit të demokracisë tonë lokale. Si pasojë, 40% i numrit të përgjithshëm të administratorëve në komunë dhe ndërmarrjet publike janë femra, 60% i kabinetit të kryetares së komunës janë femra, sekretari i komunës dhe tre nga sektorët e komunës udhëhiqen nga femra, 40% të drejtorëve të emëruar në shkollat fillore të mesme dhe çerdhet e qytetit janë femra. Me ngritjen e përqindjes së femrave në funksione udhëheqëse është ngritur niveli i interesimit dhe është lehtësuar qasja e femrave tjera për të artikuluar interesat e tyre dhe për të marrë pjesë aktive në jetën sociale, ekonomike dhe kulturore të qytetit. Kjo politikë nuk nënkupton se qëllimi ynë është feminizimi i institucioneve dhe jetës publike po kontributi në zhdukjen e paragjykimeve dhe stereotipeve dhe krijimi i kulturës institucionale që është e ndjeshme për nevojat dhe interesat e dy gjinive në mënyrë të barabartë.

Komuna jonë është nënshkruese e Kartës evropiane për barazi mes femrave dhe meshkujve. Ne qershor të vitit 2016 sollim Planin aksionar për mundësi të barabarta ndërmjet grave dhe burrave për vitin 2016-2017. Në kuadër të këtij plani aksionar parashihet përgatitja e strategjisë për barazi gjinore dhe për këtë qëllim është formuar edhe grup punues ku marrin pjesë administratore komunal edhe përfaqësues nga sektori civil. Komuna e Tetovës ka përkrahur vazhdimisht projektet e organizatave jo qeveritare dhe kemi qenë pjesë e programeve të organizatave të huaja në vend, që kanë pasur për synim ta forcojnë, vetëdijsojnë dhe pavarësojnë gruan.



- Projekti i UNWOMAN për Programit Rajonal për Promovimin e Politikave të Përgjegjshme Gjinore në Evropën Juglindore



- USAID “Iniciativa Gratë në biznes “ Projekti i USAID për zgjerimin e bizneseve të vogla

ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL

Vizioni i Komunës së Tetovës përfshin krijimin e kushteve që mundësojnë rritje të sektorëve prodhuese dhe shërbyese - hapje të vendeve të punës me qëllim të përmirësimit të standardit jetësor, shpërndarjes së drejtë të të mirave të dala nga zhvillimi ekonomik lokal me qëllim të përfshirjes sociale - po njëkohësisht duke

pasur parasysh ruajtjen e ambientit jetësor. Pra, qasja jonë ka qenë dhe do të jetë mundësi dhe ndihma për një ‘ekonomi të gjelbër’, të integruar horizontalisht - duke përfshirë shfrytëzimin e përgjegjshëm të resurseve natyrore, shfrytëzimin efektiv të resurseve njerëzore, përpilim të programeve arsimore që u përgjigjen kërkesave aktuale të tregut të punës, shfrytëzimin efikas të tokës ndërtimore dhe implementim të infrastrukturës komunale në funksion të zhvillimit ekonomik - si dhe të një ekonomie të integruar vertikalisht - që harmonizon qëllimet strategjike, politikat dhe programet e zhvillimit regjional dhe nacional të dala nga sektorët e ndryshme zhvillimore, me ato të Komunës së Tetovës. Në këtë mënyre tendenca e jonë gjithmonë ka qenë të kemi një qasje gjithëpërfshirëse që garanton suksesin.

Në këtë kontekst, themi që harmonizimi vertikal është me rëndësi esenciale, pasi që aktivitetet e zhvillimit ekonomik të një shteti ndodhin në nivelin lokal. Komunikimi i vazhdueshëm mes niveleve qeveritare - lokale, regjionale, nacionale - që reflekton drejtë nevojat e qytetarit dhe në mënyrë të vazhdueshme është argument kyç për një zhvillim ekonomik të qëndrueshme. Përndryshe, çdo politikë e zhvillimit ekonomik - sado që mirë të jetë përpiluar - është e destinuar të dështojë në qoftë se implementimi nuk i është përshtatur kontekstit lokal, apo mungon harmonizimi i sektorëve të ndryshëm në vertikalen qeverisëse. Pra, për te korrur sukses, duhet pasur parasysh që të gjitha aspektet e planifikimit të zhvillimit ekonomik lokal të jenë mirë të harmonizuara, por njëkohësisht të lejojnë fleksibilitetin dhe agjilitetin për kyçje të drejtpërdrejta të ‘aktorëve’ lokal: zejtarëve dhe odave zejtare, bizneseve dhe odave ekonomike, kllasterëve industrial të industrive të ndryshme, OJQ-ve, si dhe institucioneve edukativo-arsimore të çdo niveli. Nga kjo ide buron edhe programi ynë për zhvillimin ekonomik lokal për periudhën 2017-2021, i cili në qendër të zhvillimit ekonomik lokal, vendos qytetarin e Komunës së Tetovës. Koncepti i vendosjes së qytetarit në qendër të zhvillimit ekonomik nuk është ide e rastësishme, por një koncept strategjik që ka buruar nga eksperiencia jonë në menaxhim të ZHEL në komunën tonë.

Nisur nga kjo, programet tona nga vitet e kaluara janë mbi ndërtuar vazhdimisht për të adoptuar konceptin qytetar që në thelb kanë vendosur sektorët e zhvillimit urban, infrastrukturës/komunikacionit dhe arsimit në shërbim të ZHEL. Në këtë mënyrë kemi përmirësuar kushtet elementare të domosdoshme për një mjedis urban që favorizon aktivitetet ekonomike: furnizim me ujë të pijshëm, përpilim

i dokumentacionit teknik dhe tenderim i sistemit për menaxhim me ujera të zeza, zgjidhje lokale dhe regjionale për menaxhim me mbeturina, përmirësim i infrastrukturës rrugore, përmirësim në proceset e planifikimit urban, riorganizim i programeve arsimore në shkolla të mesme, si dhe ngritje e bashkëpunimit me universitetet. Të gjitha këto projekte, në mënyrë indirekte kanë rritur volitshmërinë dhe avancuar kushtet për investime dhe aktivitete afariste.

Në një nivel më të avancuar që tani më ka filluar të zbatohen projekte që në mënyrë të drejtpërdrejtë të ndihmojnë zhvillimin ekonomik lokal:

Qendra për kompetenca (Vocational Education Training Center): Proekt i përbashkët i Komunës, Qendrës për zhvillim të Pollogut, OEMVP dhe afarist nga sektori i ndërtimtarisë, për të krijuar qendër të pajisur për mësim-edukim praktik në nëntë lëmi të zejeve të ndërtimit, siç janë: elektrikist, ujë instalues, murator, etj. Qendra do të jetë e vendosur në hapësirat e Shkollës së mesme profesionale, hapësirat e cilës do të përdoren me orare të ndryshme nga nxënës dhe punonjës aktiv në sektorin e ndërtimtarisë. Pajisjet do të sigurohen nga komuna dhe fonde të jashtme, ndërsa materialet për punë praktike nga afaristët që do të përbëjnë konsorciumin.

Zyra e diasporës do të mundësojë thithjen e investimeve të huaja (DDI-Diaspora Direct Investment). Duke kuptuar rëndësinë dhe peshën e investimeve të diasporës shqiptare në Maqedoni, e në veçanti në rajonin e Pollogut, Komunitat nga rajoni të prira nga Qendra për zhvillim rajonal dhe Komuna e Tetovës kanë hulumtuar bizneset, tregun e investimeve, kanë realizuar takime pune në Berlin të Gjermanisë me Asociacionin ekonomik Gjermano-Shqiptar, si dhe entitete publike* në Kosovë, për të përpiluar bazën e përbashkët e të dhënave për shfrytëzim nga zyra në fjalë. Po ashtu, Komuna e Tetovës ka siguruar hapësirat, ndërsa Qendra për Zhvillim Rajonal ka përgatitur hapësirat fizike për këtë zyrë. Në të ardhmen, kjo zyrë përveç lehtësimeve administrative, teknike dhe logjistike për aktivitete afariste nga fusha e DDI, do të ofrojë edhe shërbime të përshtetshme qytetare -fast track- për pjesëtarë të diasporës nga rajoni.

Proekti STEP (Smart Tourism Enhancement Project) - Projekt i financuar nga IPA për bashkëpunim ndër-kufitar Shqipëri- Maqedoni, në bashkëpunim me Qendrën Rajonale të Pollogut, Qarkun e Elbasanit dhe Metamorphosis Foundation. Ky projekt parasheh trajnim për përdorim të online platformave (TripAdvisor, Booking, etj), për individ dhe biznese që ofrojnë shërbime hotelerie, në Elbasan

dhe kryesisht në viset rurale të Malit Sharr. Po ashtu, me këtë projekt parashihet ndarja e granteve të vogla, 3000-5000 EUR, me qëllim të ngritjes të kapaciteteve turistike për ndërmarrës të vogël turizmi, në rajonet ndërkufitare të Pollogut dhe Elbasanit. Më tej, projekti parashih ndërtimin e web platformës që integron ofertën nga të gjitha online platformat turistike, për zonën ndërkufitare si dhe ofron mundësinë e kombinimit të ofertave ekzistuese, duke hapur mundësinë e punësimit individual për individ të papunësuar.

Me projektin FRET -STIC (Fostering Rural and Environmental Tourism through Smart Tourist Information Centres) i financuar nga programi i bashkëpunimit ndërkufitar Kosovë- Maqedoni, në bashkëpunim me Rajonin Jug të Prizrenit, parashihet ndërtimi i sistemit IT që jo vetëm rrjetëzon qendrat e informimit për turistë, por që krijon shabllone gjenerike për shërbim/ mbledhje të informatave nga turistët, si dhe krijim të ofertave të veçanta sipas meta-të-dhënave të mbledhura. Më tej ky projekt bën mbledhjen e informatës dhe krijimin e matricës mbi të gjitha pozicionet turistike dhe eventet me interes të veçantë. Si të tilla, subjekteve relevante u jepen informata për të ngritur cilësinë e ofertës, adaptimin sipas target grupeve, si dhe avancimin e mundësive për marketing dhe promovim të produkteve turistike.

Projekte dhe aktivitete të ngjashme që përmirësojnë dhe avancojnë kushtet në industri të ndryshme, komuna e Tetovës në vazhdimësi ka ndjekur, zbatuar dhe do të vazhdojë të zbatojë me një qasje të përmirësuar dhe mbi ndërtuar nga eksperiencat e veta dhe ato të përfituara nga bashkëpunimet që ka. Me rëndësi është që programi ynë për ZHEL identifikon suksesshëm aktivitetin socio-ekonomik të ‘qytetarit’ tonë, e analizon në mënyrë të drejtë, dhe vendos të gjitha resurset dhe mjetet në shërbim të avancimit të pozitës së tij në kuadër të shoqërisë tonë.

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM URBAN

Zhvillimi i qëndrueshëm urban arrihet përmes procesit të përmbushjes së objektivave të banorëve të një qyteti, pa rrezikuar resurset natyrore duke siguruar qëndrueshmëri ekologjike, sociale dhe ekonomike për gjeneratat që vijnë. Një qytet që zhvillohet në mënyrë të balancuar është një qytet i qëndrueshëm që ka

baraspeshë mes dimensionit social, hapësinor dhe ekonomik. Sipas statistikave zyrtare të vitit 2002 komuna e Tetovës numëron 90 000 banorë ndërsa dendësia e popullsisë është nga më të lartat në Evropë, afër 379 banorë në 1km². Për t'i orientuar dinamikat e ndryshimeve të vazhdueshme sociale, mjedisore dhe ekonomike në kahje të zhvillimit të qëndrueshëm të zonës urbane dhe rurale, komuna e Tetovës ka ndërmarrë një sërë masash dhe aktiviteteve që do të prezantohen në vijim së bashku me vizionin për vitet e ardhshme.

PLANI GJENERAL URBANISTIK DHE PLANET DETALE URBANISTIKE

Komuna e Tetovës ka ndërmarrë iniciativë për përpunimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit gjeneral urbanistik në pajtim me Ligjin për Planifikim urbanistik dhe hapësinor (G. Zyrtare e RM-së nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 163/16) dhe Programit për përpunimin e planeve urbanistike të komunës së Tetovës për vitin 2016 miratuar nga ana e Këshillit të komunës së Tetovës në seancën e mbajtur më 29.12.2015 vj., me nr. 08-6481/13 me datë 29.12.2015 si dhe programit për përpunimin e planeve urbanistike të komunës së Tetovës për vitin 2017 miratuar nga ana e Këshillit të komunës së Tetovës, me nr. 08-11142/25 me datë 31.10.2016 .

Me hapjen e procedurës tenderike është përzgjedhur firma për përpunimin e bazës së përditësuar gjeodezike në të cilën është i realizuar azhurnimi i bazës gjeodezike për përfshirjen planore të qytetit të Tetovës, si fazë fillestare për përpunimin e Planit gjeneral urbanistik të qytetit të Tetovës. Tani jemi në fazë të përpilimit të detyrës projektuese që do të paraqesë bazë për hapjen e procedurës së tenderimit për përzgjedhjen e ndërmarrjes për planifikim që do ta përpunojë Planin gjeneral urbanistik ku parashikohet edhe zgjerimi i të njëjtit plan në krahasim me atë që është i miratuar në vitin 2003.

Procedura e përgatitjes së planit gjeneral urbanistik për qytetin e Tetovës zhvillohet në disa faza edhe atë në fillim duke bërë përzgjedhjen e firmës projektuese e cila duke u bazuar në elaboratin gjeodezik do të bëjë përpunimin e Planit propozues, pas të cilit pason diskutimi profesional në lidhje me plan projektin e ndryshimit dhe plotësimit të PGJU-së.

Synimet e Planit Gjeneral Urbanistik janë:

- harmonizimi i kërkesave individuale të komunitetit dhe interesave të përgjithshme
- shfrytëzimi i mundësive që ofron lokacioni dhe harmonizimi me synimet zhvillimore të qytetit
- hartimi i një plani të zbatueshëm, duke respektuar parimet për ambient të qëndrueshëm, funksional dhe të shëndoshë

Me përpunim e ndryshimit dhe plotësimit të PGJU-së nënkuptojmë rregullimin e rrjetit të komunikacionit, ndryshimin e blloqeve urbane, ndryshimin e destinimeve aktuale, planifikimin e hapësirave për parkingje, planifikimin e zonave të gjelbra, infrastrukturës, objekteve shkollore dhe objekteve tjera me karakter publik. Për krijimin e një koncepti të arsyeshëm policentrik në planifikimin e zgjerimit të planit gjeneral të qytetit do të merren parasysh edhe këta faktorë:

- kushtet natyrore (topografike, gjeologjike, hidrologjike, klimatike, pedologjike, etj)
- sipërfaqja aktuale e tokës së pa ndërtuar (toka bujqësore, hapësirat e gjelbra, etj),
- sipërfaqja aktuale e tokës së ndërtuar
- parashikimet demografike deri në vitin 2027, dendësia e banorëve e parashikuar, gjegjësisht qëllimet për planifikim në lartësi,
- dendësia e ultë banuese, sidomos në pjesët periferike të qytetit.

Pra me Planin Gjeneral Urbanistik do të mundësohet mbrojtja dhe avancimi i ndërtesave dhe i komplekseve me karakter historik dhe kulturor si dhe integrimi i tyre në rrjedhat bashkëkohore. Trashëgimia e ruajtur do të jetë element i rëndësishëm në kompozimin e siluetës së përgjithshme të qytetit. Gjithashtu, do të parashihet trashëgimia kulturore-historike si një nga potencialet e zhvillimit ekonomik. Afirmimi i vlerave trashëgimore të Tetovës paraqet aspekt të veçantë për zhvillimin e sektorit të turizmit në të gjitha potencialet me të cilat posedon Tetova. Njëherit, kjo do të ketë rëndësi të posaçme në zhvillimet makro urbane

në lëmine e turizmit duke u bazuar në afërsinë me resurset natyrore të vlerave të veçanta dhe atraktive si: mali Sharr, aeroporti i Shkupit etj, të cilat janë potencial për zhvillim të mirëfilltë të turizmit rekreativ stacionar, turizmit për fundjavë, atij veror dhe dimëror, dhe ku mund të zhvillohen aktivitete rekreative . Me rregullimin e statusit juridiko pronësor të kazermës me ndryshimin dhe përpunimin e PGJU, planifikohet urbanizimi i zonës te gjendet kazerma e qytetit (BU9) .

Rrjeti ekzistues i trafikut automobilistik do të integrohet me modalitetet tjera të trafikut duke e ngritur cilësinë dhe lidhshmërinë e qytetit të Tetovës në një tërësi integrale dhe duke i vendosur skemat e të gjitha modaliteteve në veçanti. Ecja dhe çiklizmi do të jenë të përshtatshme dhe të këndshme si mënyrë e trafikut dhe si formë e rekrutimit, sidomos te rrugët e ngushta të qytetit ku trafiku automobilistik do të ishte krejtësisht i ndaluar, përpos për raste emergjente.

Po ashtu, PGJU i ri do të mundësojë avancimin e infrastrukturës ekzistuese – uji, energjetika, telekomunikimi - do të bazohen në resurset ekzistuese nëntokësore dhe mbitorësore të komunës duke i shfrytëzuar ato në mënyrë racionale me metoda më bashkëkohore dhe gjithnjë duke pasur parasysh mbrojtjen e ambientit dhe mos shkatërrimin e këtyre resurseve. Plotësimi me kapacitete shtesë për infrastrukturë do të bëhet prej sistemeve të mëdha të rajonit.

Do të planifikohet një sistem i ri i integruar për infrastrukturë të re (uji, rrjeti i ujërave të zeza dhe atmosferik, energjia elektrike, gazifikimi dhe fijet optike të telekomunikacionit) në të gjitha akset e reja rrugore dhe në rrugët ekzistuese të cilat kërkojnë një rekonstruim të tërësishëm për t’i përmbushur kërkesat e reja. Menaxhimi i hedhurinave do të bëhet në pajtim me direktivat evropiane. PGJU do të parashikojë hapësira të rekreimit në dobinë e qytetarëve por po ashtu edhe me qëllim të tërheqjes së investimeve të reja që do ti shërbejnë zhvillimit ekonomik dhe të turizmit. Në bazë të ligjit për planifikim hapësinor, janë miratuar 6 iniciativa për plotësimin dhe ndryshim të blloqeve urbane nga PGJU i vitit 2003, 14 Iniciativa të miratuara për PDU si dhe 29 iniciativa janë në procedurë përfundimtare, 3 Akte të përgjithshme për fshat dhe një është në procedurë përfundimtare. Janë miratuar 13 iniciativa për DUPL ndërsa 9 janë në procedurë të miratimit. Janë miratuar 8 iniciativa për projekte arkitektonike urbanistike dhe janë miratuar katër iniciativa për projekte të infrastrukturës ndërsa një është në procedurë përfundimtare. Plani urbanistik jashtë vendbanimit për Kodrën e Diellit është në procedurë e sipër.

SISTEMI GIS

Sistemi informativ GIS (Geographic Information System) si sistem relativisht i ri merret me menaxhimin, analizën dhe paraqitjen vizuale të të dhënave hapësinore. Si disiplinë akademike, GIS-i merret me transformimin e të dhënave numerike në shënime hapësinore duke përfshirë algoritmet për analiza hapësinore, menaxhimin e të dhënave hapësinore dhe prezantimin vizuel.

Në aspektin gjeografik informatat hapësinore janë të shumëllojshme. Të gjitha aktivitetet që zhvillohen në hapësirë si ato ekonomike, joekonomike, shoqërore apo natyrore, duhet të përcillen apo të monitorohen, qofshin ato të dobishme apo të dëmshme për shoqërinë. Monitorimi i këtyre aktiviteteteve është i dobishëm në mënyrë që të bëhet planifikimi i hapësirës dhe organizimi i saj sa më i favorshëm për shoqërinë. Objektet dhe proceset natyrore monitorohen në mënyra të ndryshme, por këto kanë kuantitetin e vet që mund të shprehet në vlera numerike që shprehin madhësinë në kohë dhe në hapësirë.

Për këtë qëllim komuna e Tetovës ka marrë iniciativë për përdorimin e një sistemi të tillë me qëllim të mbledhjes sa më të shpejtë të informatave, pra çdo gjë që zhvillohet në kohë dhe në hapësirë merr karakter gjeografik dhe do të jetë sa më transparente për qytetarët.

Janë të realizuara disa trajnime zyrtare nga ana e komunës së Tetovës në lidhje me Sistemin informativ GIS (Geographic Information System) dhe pretendojmë që ky sistem të jetë sa më shpejt aktiv në komunën e Tetovës që do t'ua lehtësojë punën edhe administratorëve të komunës por njëkohësisht edhe qytetarëve për të pasur qasje më direkte dhe transparente në planifikimin urbanistik të qytetit të Tetovës. Me përfundimin e regjistrimit të të dhënave që i posedon komuna në sistem, sistemi do të jetë aktiv për të gjithë qytetarët.

LEGALIZIMI I OBJEKTEVE PA LEJE

Procedura për legalizimit bazohet në Ligjin për legalizim dhe përfshin ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më 2011, me funksione banimi, veprimtari ekonomike apo funksione të tjera social-kulturore, dhe që disponohen nga individë apo

persona juridikë të regjistruar, përfshirë dhe ndërtimet pa leje, për të cilat subjektet nuk kanë kryer procedurën e vetë deklarimit për legalizim, sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj. Nga viti 2011 deri te Komuna e Tetovës janë të dorëzuar gjithsej 11590 kërkesa për përcaktimin e statusit juridik ndërsa deri më tani janë përfunduar 3900 procedura për legalizim. Sa i përket këtij procesi, ne kemi ndjekur parimin që procesi i legalizimit të objekteve të ndërtuara pa leje që nuk nënkupton ligjërim të çdo shkeljeje dhe keqpërdorimi të territorit të këtij qyteti por proces të përpunimit të dokumentacionit të dorëzuar nga palët në pajtim me dispozitat ligjore dhe standardet urbanistike dhe arkitektonike.

INFRASTRUKTURA RRUGORE, PARKIMI DHE TRANSPORTI PUBLIK

Plani zhvillimor shumë sektorial urbanistik ka përcaktuar synimet afatgjate për zhvillim dhe menaxhim të zonave urbane sipas planit ekzistues gjeneral urbanistik ku janë caktuar prioritete për rehabilitimin e infrastrukturës ekzistuese rrugore dhe ndërtimin e rrugëve të reja. Në bazë të këtij plani nga viti 2013 janë ri definuar rrugët e qytetit dhe është investuar në përmirësimin e infrastrukturës rrugore me qëllim të krijimit të rrjetit funksional rrugor. Në këtë drejtim janë rindërtuar rrugët e qytetit duke filluar nga zona qendrore me rindërtimin e bulevardit Iliria, njërit nga dy bulevardet kryesore që ka Tetova, një pjesë e rrugës industriale si rrugë kryesore që lidh autostradën Tetovë – Shkup me autostradën Tetovë – Gostivar, duke vazhduar në rrugët dytësore për të përfunduar me rrugët që lidhin zonën urbane me pjesët rurale.

Për arsye të infrastrukturës së amortizuar rrugore në zonat urbane dhe rurale, investimet infrastrukturore janë ndërmarrë në drejtim të rehabilitimit të rrjetit rrugor dhe ndërtimit të rrugëve të reja. Zhvillimi i pabarabartë mes një njësie të ndryshme vendore shkaktonte vështirësi në ndërtimin dhe avancimin e një infrastrukture të përbashkët. Infrastruktura e amortizuar ka ndikuar negativisht në zhvillimin e shumë zonave të komunës, veçanërisht të zonave rurale, sidomos në pjesën malore. Edhe rrugët e brendshme të qytetit kishin nevojë për ndërhyrje, sidomos në pjesët periferike të qytetit. Ndërhyrja në infrastrukturën rrugore ishte një nga prioritetet kryesore për arsye se përmirësimi i infrastrukturës lidhëse

ndikoi dukshëm në rritjen e kohezionit social dhe në rritjen e qasjes të popullatës se zonave rurale në shërbimet bazë të komunës.

Sa i përket pjesës urbane të komunës është bërë rikonstruimi i tërësishëm i Bulevardit Iliria dhe u ndërtua edhe shtegu i biçikletave ku u vendosën shtyllat mbrojtëse me qëllim të vazhdimit të investimit në këtë pjesë qendrore të qytetit dhe të formësimit të një tërësie funksionale. Në vijim është rikonstruimi i trotuareve ndërsa me përfundimin e realizimit të projektit do të vendosen pajisjet urbane që do të mundësojnë shfrytëzim maksimal të këtyre hapësirave nga ana e qytetarëve. Më tej u investua në rrugët sekondare të qytetit duke përfshirë këtu rikonstruimin e tërësishëm të rrugës Gjorçe Petrov dhe Cvetan Dimov, rikonstruimi i pjesës së sipërme të rrugës V.S Bato dhe trotuareve, rikonstruimi i rrugës për qasje në spital, rikonstruimi i rrugës Kongresi i Manastirit bashkë me unazën, rikonstruimi i rrugës Vëllezërit Miladinov nga bulevardi i Ilindenit deri tek rruga Gjorçe Petrov, rikonstruimi i rrugës në lagjen Dardania, asfaltimi i rrugës Gjorçe Petrov pas gjimnazit, rikonstruimi i rrugës Vëllzërit Simovski, rikonstruimi i rrugës Kuzman Josifovski Pitu tek Tetovarja dhe rrugës mbi stadiumin e qytetit prej te varrezat ortodokse deri tek shkolla e mesme “7 Marsi”. Po ashtu është bërë pllakëzimi i rrugës Vëllezërit Miladinov, rrugës Murat Baftijari, dhe tek Bregu i Diellit pllakëzimi i rrugës 146. Është intervenuar edhe në rregullimin e shumë pusetave në lagjen Migjeni dhe asfaltimin e tërësishëm bashkë me rrethin te stadiumi.

Po ashtu është bërë rikonstruimi i një pjese të rrugës industriale dhe rrugëve sekondare që lidhen me të, duke përfshirë këtu rikonstruimin dhe asfaltimin e Bulevardit V.S. BATO prej te monopoli deri tek Ekologu. U bë edhe rikonstruimi dhe asfaltimi i rrugës jashtë Vardarit. Duke vazhduar më tej në pjesën e Reçicës së Vogël është bërë rikonstruimi i plotë i rrugës 172 (nga bulevardi i Ilindenit deri në rrugën Lubotenska). Në fazën perfundimtare të ndërtimit është rikonstruimi i rrugës Tetovë-Brodec (rruga e banjës) si dhe ndërtimi i Urës së Kazazëve.

Gjatë rehabilitimit të infrastrukturës rrugore është tentuar që paralelisht të rinovohet rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit fekal dhe atmosferik si një prioritet që do mbetet ndër prioritetet tona kryesore edhe në të ardhmen. Në këtë drejtim, është bërë rinovimi i ujësjellësit në rrugën D.G.Kara, ndërtimi i linjës së ujësjellësit në rrugën Dervish Cara, riparimi i linjës së ujësjellësit në rrugën 172 në Reçicë të Vogël, ndërtimi i linjës së ujësjellësit në rrugën Lenin dhe ndërtimi i kaptazhës në malin Sharr në vendin e ashtuquajtur Rokoçeç. Është bërë



ndërtimi i kanalizimit fekal në rrugën Dervish Cara, ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik dhe një linjë e ujësjellësit në rrugën 120, ndërtimi i kanalizimit fekal në rrugën e banjës, kanalizimi në rrugën Borce Kočovski , kanalizimi fekal ne rrugën 165 në Reçicë të Vogël, kanalizimi fekal ne rrugën 174 në Reçicë të Vogël, ndërtimi i kanalizimit fekal te shkolla e mesme e Medicinës. Sa i përket kanalizimit atmosferik, është rregulluar kanalizimi atmosferik në lagjen jashtë Vardarit, kanalizimit atmosferik në rrugën Bllagoja Toska përballë shkollës tekstile, rregullimi i kanalizimit atmosferik në rrugën 166 në Reçicë të vogel, vendosja e kanalizimit atmosferik në rrugën Ivo Ribar Lola etj.



Në vijim janë punët ndërtimore për ndërtimin e bazenit të ujit në lagjen Bregu i Diellit ndërsa kemi planifikuar edhe pllakëzimin e rrugës në lagjen Kolltuk.

Sfidë tjetër ngel infrastruktura që lidh komunën tonë me komunat tjera pasi në këto kushte do të duhet të tenderohej dhe zbatohet në dy pjesë nga secila komunë, me dy projekte të ndryshme dhe jo domosdoshmërisht me një lidhje logjike mes tyre dhe me të njëjtin efektivitet. Mirëpo ne kemi qenë këmbëngulës dhe kemi punuar bashkërisht me komunat tjera për të realizuar një projekt shumë të rëndësishëm për Tetovën që do të lehtësonte komunikacion e tej ngarkuar

brenda qytetit.

Ndërtimi i qarkores që do të kalojë nga fshati Trebosh dhe do të lidhet në fshatin Neproshten përpos përfitimeve të shumta që do ketë, me rëndësi është të theksohet se do të ndikojë edhe në uljen e ndotjes së ajrit për arsye se do të ulët numri i automjeteve që kanë përdorur qytetin si rrugë tranzitore. Gjithashtu, në bashkëpunim me komunat e rajonit të Pollogut do të realizohet projekti për ndërtimin e rrugës që shpie në deponinë rajonale Rusino, projekt që kap vlerën investive prej 850.000 euro nga të cilat tani me 250.000 janë miratuar nga Ministria për vetëqeverisje lokale.

Duke pasur parasysh frekuencën e madhe të qarkullimit në pjesën qendrore të qytetit por edhe në pjesët kyçe siç janë hyrja e qytetit nga autostrada Shkup Tetovë por edhe rrugët kryesore që shpiten në dalje të qytetit kah autostrada Tetovë - Gostivar, përveç projektit për ndërtim të qarkores Trebosh-Neproshten, kemi punuar edhe në dy zgjidhje teknike infrastrukturore që do të çlirojnë qarkullimin e automjeteve në këto pika kyçe që rezultojnë të jenë pika kritike të qytetit. Njëra prej zgjidhjeve do të jetë ndërtimi i bulevardit V.S.Bato (rrugës industriale) që do të kalojë pranë kazermës së qytetit dhe do të vazhdojë për në fshatin Poroj. Dokumentacioni teknik është përgatitur dhe vlera e përgjithshme e investimit është 2.700.000 euro. Zgjidhja e dytë është ndërtimi i bulevardit të Ilindenit nga Universiteti i EJK deri te punkti pagesor në dalje të qytetit në rrugën për në Gostivar. Edhe për këtë projekt është përpunuar dokumentacioni teknik dhe vlera e përgjithshme e investimit është 1.000.000 euro. Përpos dekoncentrimit të qarkullimit brenda qytetit këto bulevarde do të ndikojnë dukshëm edhe në parandalimin e ndikimeve negative në mjedisin jetësor, sigurisë në komunikacion dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore brenda qytetit.



NDRIÇIMI PUBLIK

Krahas mirëmbajtjes së vazhdueshme të rrjetit ekzistues të ndriçimit publik komuna e Tetovës në bashkëpunim me Qendrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim të Republikës së Sllovenisë gjatë vitit 2017 realizoi projektin për modernizim të sistemit të ndriçimit rrugor me efikasitet energjetik- LED poçe në rrugët :

- Gjorçe Petrov në shtrirje prej rr. Vëllezërit Miladinovi deri te rr. Cvetan Dimov
- Mehmet Pashë Deralla në shtrirje nga bul. "Ilindeni" deri në bul. "V.S.Bato"
- Rruga nga lagja Drenovec deri në vendbanimin Poroj.



Për ta rregulluar kaosin në komunikacionin e qytetit, në vitin 2014 themeluan Ndërmarrjen për menaxhim me parkingjet e cila menaxhon parkingjet publike, parkimin zonal dhe parkingjet e mbyllura në pronësi të komunës. Komuna menaxhon me dy parkingje të mbyllura njëri përballë gjyqit (P1) dhe tjetri pas restorantit Arbi (P2) me 155 vend parkime ndërsa në funksionalizim e sipër është parkingu i tretë në rrugën Boris Kidriç në bllokun banesor 37. Parkingjet zonale ndahen në zonën A që përfshin pjesën qendrore të qytetit pra Bulevardin “Ilinden” dhe “Iliria” dhe zonën B që përfshin rrugët dytësore të qytetit. Zona A përfshin 193 vend parkime ndërsa zona B përfshin 285 vend parkime.

Mandatin e ardhshëm do të realizohen tre projekte për të shtuar kapacitetin parkingjeve në qytet edhe atë :

- Dy garazhe në kate në Bllokun urban 32 në planin detal urbanistik të së cilit janë paraparë dy parcela ndërtimore për realizimin e projektit të garazhës në kate dhe
- Parkingu nëntokësor në bllokun urban 99 po ashtu i paraparë me planin e ri detal urbanistik për këtë bllok urban

Po ashtu në procedurë është edhe miratimi i PDU në blloqet urbane 7, 8, 16, 27 dhe 29 në të cilat janë të parapara parcela ndërtimore për ndërtimin e garazheve në kate.

Organizimi dhe funksionalizimi i transportit publik është njëra ndër nevojat prioritare të qytetit i cili ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rrjedhën normale në komunikacionin e qytetit si dhe mbrojtjen e ajrit ambiental. Komuna e Tetovës në vitin 2014 themeloi Ndërmarrjen për transport publik me idenë që transporti publik të organizohet në sistem modern të integruar të transportit urban dhe ndër-urban me linja të rregullta në relacionet urbane dhe ndër-urbane të cilat do të shfrytëzojnë stacione të përbashkëta.

Me qëllim të funksionalizimit të ndërmarrjes dhe në mungesë të mjeteve vetanake kërkua nga qeveria ndarjen e tetë autobusëve me shembullin e ndarjes së autobusëve për qytetin e Shkupit mirëpo kjo kërkesë deri më sot nuk është miratuar. Si zgjidhje alternative, për të funksionalizuar ndërmarrjen mandatin e ardhshëm planifikojmë vendosjen e sistemit të posaçëm të shpërndarjes së linjave të transportit në kuadër të të cilit do të angazhohen transportuesit privat që posedojnë licenca për transport në komunën e Tetovës. Të gjithë transportuesit privat do të marrin kompensim të caktuar për shërbimin e tyre ndërsa komuna e



Tetovës do të inkasojë mjetet nga shfrytëzimi i këtij shërbimi nga ana e qytetareve bazuar në aktet juridike komunale për përcaktimin e këtij kompensimi. Sistemi softuerik do të sigurohet nga ana e Komunës së Tetovës ndërsa implementimin e të njëjtit do ta bëjë ndërmarrja publike për transport. Bartës kryesor i transportit publik do të jetë ndërmarrja për transport publik kurse do të mund të marrin pjesë të gjithë transportuesit privat që do lidhin marrëveshje me komunën e Tetovës për mbajtje të linjave të caktuara. Shpërndarja e linjave transportuese do të behet nëpërmjet shpalljes publike.

GAZIFIKIMI I KOMUNËS SË TETOVËS

Sistemi i gazifikimit në Komunën e Tetovës është një ndër prioritetet kryesore të parapara në Strategjinë për zhvillim ekonomik lokal të Komunës së Tetovës 2017-2021. Përpos përfitimeve të shumta nga ky projekt, ndër më të rëndësishmet e theksojmë uljen e shpenzimeve të energjisë elektrike të institucioneve publike, amvisërive dhe kapaciteteve industriale por në të njëjtën kohë duke ndikuar në uljen e ndotjes së ajrit. Projekti paraqet aplikimin e një metode të re inovative të gazifikimit, projekt i cili do të sigurojë punësime të reja dhe aplikim të teknologjive të reja, nëpërmjet të ashtuquajturit gazifikim virtual apo gazifikim hapësinor të komunës. Gazsjellësi virtual apo hapësinor (Virtual-Pipeline) është një metodë alternative e gazifikimit në kushte kur nuk kemi ndërtim të rrjetit për distribuim të gazit. Projekti bazohet në një sistem modular të ruajtjes së gazit - stacion bazik si dhe kompresimit dhe transportit të gazit natyror duke përdorur module të shoqëruara me platforma të lëvizshme, të cilat transportohen me kamionë.

Nga stacioni bazik nëpërmjet stacioneve rregullative matëse të gazit dhe rrjeteve primare dhe sekondare të distribuimit, gazi distribuohet deri te konsumatorët. Sistemi i tërë është me mbikëqyrje nga larg, menaxhim të sigurt dhe kontroll të konsumit të përgjithshëm të gazit natyror. Kontrolli dhe mbikëqyrja e këtillë nga larg mundëson lajmërim në kohë për sasinë e harxhuar të gazit si dhe për nevojën për mbushje të moduleve në stacionin bazik.

Më poshtë është paraqitur procesi i rimbushjes së moduleve me gaz natyror të kompensuar si dhe mënyra e zëvendësimit të moduleve të zbrazura me module të mbushura me gaz natyror.



Nga stacioni bazik, distribuimi i gazit nëpërmjet rrjetit primar dhe sekondar të gazifikimit, mund të shërbejë edhe si lëndë djegëse për automjetet dhe mjetet transportuese në të cilat ka të montuar pajisje për gaz. Me këtë mundësohet ulja e shpenzimeve për transport dhe në të njëjtën kohë ulet ndotja e mjedisit jetësor në komunë. Më poshtë kemi paraqitur stacionet për mbushje me gaz natyror.



Për përcaktimin e kapacitetit për gaz natyror në komunën e Tetovës janë shfrytëzuar të dhënat nga Plani aktual gjeneral, planet detale, sistemi informativ i Kadastrës si dhe të dhëna nga Programi për efikasitet energjetik të komunës së Tetovës. Vlera e përgjithshme e planifikuar e investimit për realizmin e sistemit distributor kap vlerën prej 3 milionë euro, nga i cili investim 1,5 milionë euro janë paraparë për rrjetin primar të distribumit dhe 1,5 milionë euro për rrjetin sekondar të distribuimit.

TRAJTIMI I UJËRAVE TË ZEZA DHE RRJETI I KANALIZIMIT

Sistemi i kanalizimit në komunën e Tetovës, është kryesisht rrjet i ndarë. Rrjeti i kanalizimit fekal e përfshin komunën e Tetovës dhe 70% të vendbanimit Reçicë e Vogël. Rrjeti fekal përfshin rreth 95% të qytetit të Tetovës, ndërsa rrjeti atmosferik është më pak i zhvilluar dhe përfshin rreth 50% të qytetit. Kolektorët rrugor gravitojnë në drejtim të kolektorit kryesor, i cili çon në drejtim të lumit Vardar. Derdhja e këtij kolektori në lumin Vardar është para fshatit Pallaticë, pas urës së autostradës, me ç' rast ujërat e zeza të pa trajtuara derdhen në lumin Vardar ndërsa ujërat atmosferikë derdhen në lumin Shkumbin. Vendbanimet e tjera të këtij rajoni, Poroji, Xhepçishti, Reçica e madhe dhe Reçica e Vogël të

cilat e paraqesin pjesën më të madhe të popullsisë së rajonit po ashtu nuk janë të pajisura me sisteme kanalizimi. Ujërat e zeza, shkarkohen në gropa septike të cilat e ndotin ujin e akumulacionit nëntokësor të fushëgropës së Pollogut

Nga viti 2014 përmes Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, komuna e Tetovës është përfituese e Projektit për rikonstruimin e sistemeve të kolektorëve dhe rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimin e stacionit për trajtim të ujërave të zeza në Tetovë. Projekti përfshin zonën urbane dhe fshatrat Reçicë e Madhe, Reçicë e Vogël, Falish, Poroj dhe Xhepçisht. Projekti është pjesë e prioritetit të përgjithshëm nacional për rikonstruksionin dhe modernizimin e infrastrukturës në Maqedoni, përfshirë këtu edhe sektorin e ujërave, në përputhje me kërkesat dhe standardet e Bashkimit Evropian. Ky projekt investues për trajtimin e ujërave të zeza në Tetovë, në vlerë prej 30 milion euro financohet nga mjetet e instrumentit para-aderues (IPA II) ndërsa zbatimi i tërësishëm i saj do të përfundojë për 10 vite.

Projekti për infrastrukturë për ndërtimin e objektit dhe projekti themelor për ndërtimin e kolektorëve për bartjen e ujërave të zeza prej qytetit të Tetovës dhe vendbanimeve Reçicë e Madhe, Reçicë e Vogël, Falish, Poroj dhe Xhepçisht nga komuna e Tetovës deri te Stacioni për trajtimin e ujërave të zeza (STUZ) Tetovë janë në faze përfundimtare. Komuna e Tetovës ka përgatitur dokumentacionin e projektit dhe dosjet e tenderëve për projektin investues për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza dhe do vijojë procedura e tenderimit.

Projekti përfshin përgatitjen e dokumentacionit investues – teknik për ndërtimin e rrjetit të kanalizimit dhe sistemit të kolektorit me të cilin ujërat e zeza nga qyteti i Tetovës dhe nga vendbanimet Poroj, Xhepçisht, Reçicë e Madhe, Reçicë e Vogël dhe Falisht do të grumbullohen dhe dërgohen në Impiantin e trajtimit të ujërave të zeza (IPUZ) i cili është parashikuar të ndërtohet në zonën e fshatit Falisht-Komuna e Tetovës. Studimi i fizibilitetit parashikon ndërtimin e sistemit të kanalizimit në aglomeracionin Tetovë dhe shkarkimin e ujërave të zeza në ITUZ të ardhshëm të realizohet në tri faza, si vijojnë:

Faza I: Ndërtimi i ITUZ Tetovë dhe ndërtimi i kolektorëve kryesorë për shkarkimin e ujërave të zeza nga komuna e Tetovës dhe vendbanimeve: Reçicë e Madhe, Reçicë e Vogël, Poroj dhe Xhepçisht. Në fazën e I-rë, gjithashtu parashikohet ndërtimi i rrjeteve të kanalizimit për vendbanimet: Reçicë e Madhe, Reçicë e Vogël, Falisht, Poroj dhe Xhepçisht të komunës së Tetovës

Faza – II: Ndërtimi i rrjeteve të kanalizimit dhe kolektorëve kryesorë në vendbanimet e komunave Bogovinë dhe Bërvenicë për lidhje me ITUZ Tetovë.

Faza - III: Ndërtimi i rrjeteve të kanalizimit dhe kolektorëve kryesorë në vendbanimet e komunës Zhelinë për lidhje me ITUZ Tetovë.

RRJETI I UJËSJELLËSIT



Me përfundimin e ndërtimit të gypit të ujësjellësit nga rezervuari në Leshnicë deri te rezervuari në Lumin e ftohtë dhe ndërtimit dhe vendosjes së teknologjisë bashkëkohore në stacionin për pastrim të ujit, për qytetarët e Tetovës janë siguruar 200 litra ujë në sekondë. Realizimi i këtij projekti zgjedh problemin e mungesës së sasisë së mjaftueshme të ujit ndërsa në mandatin e ardhshëm komuna e Tetovës do të :

- Intervenojë në rindërtimin, rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në territorin e saj
- vendos mekanizma për menaxhimin efikas të ujit, kontrollin e harxhimit, evitimin e humbjeve të ujit në sistem dhe tarifën e ujit

- zëvendësojë tubacionet e vjetra nga azbesti i çimentuar me material të polietilenit i cili do të sigurojë ujë cilësor për qytetarët e Tetovës
- paralelisht me rrjetin e ujësjellësit do të ndërtojë rrjetin e ujësjellësit për ujërat teknik dhe teknologjik.

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM RURAL DHE TURIZMI MALOR



Për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm në zonat rurale komuna e Tetovës ka miratuar katër akte të përgjithshme për vendbanimet rurale në të cilat janë definuar mënyra e realizimit të llojeve të infrastrukturës dhe ndërtimeve. Pra janë të definuar të gjithë drejtimet hyrëse dhe dalje ekzistuese në fshat dhe lidhjen e tij të komunikacionit me një përfshirje më të gjerë të mundësive për ndërlidhje me rrugët lokale dhe rajonale. Aktet e përgjithshme janë sjellë për fshatin Saraqinë, Falisht, Sellcë dhe Gajre. Aktet e njejta do të miratohen për të gjitha zonat rurale të komunës së Tetovës si pikënisje për zhvillimin e qëndrueshëm rural në komunën e Tetovës. Njëkohësisht është intervenuar në rehabilitimin dhe shtrirjen e rrjetit rrugor në zonat rurale për të siguruar ndërlidhjen e këtyre zonave

mes vete dhe me zonën urbane të Tetovës dhe për ta mundësuar zhvillimin e turizmit rural. Në pjesët rurale, në fshatin Vicë kemi bërë rikonstruimin e rrugës bashkë me muret mbajtëse, është vendosur kanalizim atmosferik për praninë të ujërave atmosferik, është bërë zgjerimi i rrugëve brenda fshatit dhe të njëjtat janë shtruar me pllaka bekatoni në gjatësi prej 2300m². Është zgjidhur problemi me furnizimin e ujit dhe në këtë fshat është ndërtuar kaptazha dhe linja kryesore në rezervuarin ekzistues nga burimet Kuçibeg me çka është siguruar furnizim plotësues me ujë. Gjithashtu në fshatin Sellcë është bërë pllakëzimi i rrugës lokale, rikonstruimi i rrugës nga kalaja deri ne Sellcë në gjatësi prej 1722 metra dhe sipërfaqe prej 8350m², asfaltimi i rrugës deri te xhamia e fshatit, pllakëzimi i rrugës mbi shkollën e re të fshatit si dhe riparimi i kanalizimit fekal. Në fshatin Llacë, Xhermë, Bozovcë, Brodec dhe Veshallë është bërë tamponizimi dhe pllakëzimi i rrugëve lokale. Është ndërtuar tërësisht rruga Brodec - Shipkovicë me përkrahje nga Agjencia për përkrahje të zhvillimit rural dhe të bujqësisë si dhe është bërë rikonstruimi i rrugës për në teqe të Shipkovicës, pllakëzimi i rrugës që shpie tek varrezat si dhe rikonstruimi i urës në Shipkovicë. Në fashatin Lisec është bërë rregullimi i përroit me gypa si dhe rrafshimi dhe zgjerimi i rrugës. Po ashtu edhe ne fshatin Gajre është bërë pllakëzimi i rrugëve lokale .

Në vitin 2014 është përgatitur Strategjia për zhvillim rural në Komunën e Tetovës i cili është dokument strategjik që përcakton kahjet e zhvillimit të mëtejshëm rural, mënyrën e trajtimit të resurseve, karakteristikat e mundësive për avancimin e produkteve bujqësore dhe parashikimi i mundësive të ardhshme zhvillimore ne zonat rurale për periudhën 2015-2020. Në bazë të këtij dokumenti komuna aplikon me projekte për të shfrytëzuar fondet nacionale dhe ndërkombëtare për zhvillim rural. Po ashtu, komuna e Tetovës dhe Byroja për zhvillim rajonal kanë përgatitur edhe Studim i potencialeve për zhvillim të turizmit rural në fshatrat e Malit Sharr ne komunën e Tetovës. Qëllimi kryesor i projektit është te analizohen dhe të identifikohen potencialet, vlerat dhe nevojat për ndërtim, investim dhe përmirësim të infrastrukturës dhe ofertës turistike në zonat rurale për shfrytëzim në eko-turizëm, gastro-turizëm, agri-turizem etj.

Këtë vit me 27 shtator, komuna e Tetovës në bashkëpunim me Ministrinë e ekonomisë, për herë të parë organizon shënimin e Ditës ndërkombëtare të turizmit përmes organizimit të eko-panairit të ushqimeve tradicionale nga rajoni i Tetovës me qëllim promovimin e traditës, vlerave kulturore dhe veçorive natyrore të komunës. Në mandatin e ardhshëm me mjete të IPARD dhe IPA

II bashkëpunim ndërkuftar planifikohet të zbatohen dy faza nga projekti për themelimin e Qendrës për grumbullimin dhe shitjen e pemëve dhe perimeve nga fshatrat e Malit Sharr në komunën e Tetovës, projekt ky i cili parashihet të realizohet në vitet 2017-2022.

Sa i përket Kodrës së Diellit aktualisht ekziston plani detal urbanistik i miratuar ne vitin 1980, pasi që Iniciativa e komunes së Tetovës që ishte filluar në vitin 2012 nuk u miratua nga ana e Ministrisë për Transport dhe Lidhje. Procedura u rifillua në vitin 2017 edhe atë me përpunimin e Planit urbanistik jashtë vendbanimit për qendrën-sportive rekreative Kodra e Diellit, e cila aktualisht është në fazë para anketës publike. Në krahasim me planin e vjetër urbanistik, iniciativa e re parasheh zgjerim të kufirit të përfshirjes planore. Po ashtu në përgatitje e sipër është dokumentacioni teknik për infrastrukturën rrugore në lagjen e uikend-shtëpizave në Kodrën e Diellit. Në vijim është përgatitja e dokumentacionit teknik për realizimin e këtij projekti i cili synon përmirësimin e infrastrukturës rrugore me qëllim të zhvillimit të turizmit malor.

ARSIMI KULTURA DHE RINIA

Integriteti i një shoqërie është rezultat i drejtpërdrejtë i një sistemi arsimor cilësor. Synimi kryesor i politikave tona në fushën e arsimit është arritja e zhvillimit etik, intelektual, fizik, dhe social të nxënësit, në mënyrë që të jetë i aftë të mësojë gjatë të gjithë jetës, të mendojë në mënyrë të pavarur, kritike e krijuese, t'u përshtatet ndryshimeve, të ketë vetëbesim e shpirt bashkëpunimi dhe të jetë i gatshëm të ofrojë përpjekjet e tij për mirëqenien, përparimin, lirinë e demokracinë e vendit e më gjerë. Për këtë qëllim komuna e Tetovës në bashkëpunim me Ministrinë për Arsim dhe Shkencë dhe organizatat dhe ambasadat e huaja në vend ka ndërmarrë një sërë aktivitete për të përmirësuar infrastrukturën shkollore dhe cilësinë e arsimit në shkollat fillore dhe të mesme.

Në këtë drejtim komuna e Tetovës përmes politikave të aplikuara regjistruese për shkollat e mesme arriti të krijojë paralele me numër optimal nga 35 nxënës të shkëlqyeshëm, të rrit cilësinë e procesit edukativo arsimor dhe të krijojë ambient ku nxënësit do të jenë të motivuar t'i zhvillojnë talentet e tyre, t'i zgjerojnë horizontet e dijes dhe të konkurojnë me dijet e tyre brenda dhe jashtë këtij shteti. Vendosja e kriterëve për regjistrimin e nxënësve në të gjitha shkollat

e mesme dhe orientimi i tyre konform shkathtësive dhe suksesit të treguar në shkollën fillore po ashtu ndikoi pozitivisht në ngritjen e cilësisë së arsimit dhe interesimit të nxënësve për drejtimet që ofrojnë shkollat e mesme profesionale e që janë mëse të nevojshme në tregun e punës. Si shembull, në vitin 2017-2018 përqindja e nxënësve të regjistruar në shkollat e mesme profesionale është 60 %. Gjatë kësaj periudhe përveç themelimit të Gjimnazit 7 Marsi hapëm paralele të Gjimnazit të sportit në Tetovë dhe po ashtu në gjimnazin e Qytetit për herë të parë u hap drejtimi artistik ndërsa në shkollën e mesme të Mjekësisë nga viti 2017/2018 filloi funksionimi i drejtimit për përkujdesje të personave të moshuar. Poashtu u realizua projekti për arsimin e të rriturve që u mbajt në bashkëpunim me Qendrën për arsimimin e të rriturve. Në këtë projekt u inkuadruan mbi 300 persona të cilët nuk kishën të kryer arsim të mesëm dhe u pajisën me shkathtësi nga drejtimet teknike.



Me qëllim të ngritjes së cilësisë së arsimit në bashkëpunim me Ministrinë e arsimit e cila është kompetete për investimet kapitale në infrastrukturën shkollore gjatë 4 viteve e kaluara në u rinovuan shkolla e mesme teknike, gjimnazi Kiril Pejçinoviç, shkolla e mesme Ekonomike, shkolla fillore Bratstvo-Migjeni, Rexhep Voka në Brodec, shkolla fillore Istigball, gjimnazi 7 Marsi, shkollat fillore në Veshallë dhe Gajre ndërsa në proces është rikonstruimi i shkollës fillore Liria në Tetovë.

Në bashkëpunim me ambasadën e Gjermanisë dhe Çekisë renovuam paralelet për fëmijët me nevoja të veçanta në Sh.F. “Liria” dhe Sh.F. “Kikish”. Po ashtu u ndërtuan sallat e sportit në shkollën e mesme Ekonomike, shkollën e mesme Teknike, shkollën fillore Përparimi në Reçicë. Në ndërtim e sipër është salla në shkollën fillore “RexhepVoka” – Shipkovicë ndërsa së shpejti do të fillojë ndërtimi i sallës në shkollën fillore Kikish.



Pas përgatitjes së dokumentacionit teknik për projektin dhe dhënies leje për ndërtim të shkollës fillore në fshatin Reçicë të Vogël dhe rindërtimit, zgjerimit



dhe rinovimit të shkollës së mesme të gjimnazit Kiril Pejçinoviç dhe sallave të sportit, gjatë mandatit të ardhshëm do të zhvillohen fazat e ardhëshme për realizimit dy projekteve të lartpërmendura. Me ndërtimin e shkollës fillore në Reçicë të Vogël, do të zgjidhet problemi i nxënësve të këtij vendbanimi të cilët mësojnë në shkollën fillore në Reçicë të Madhe dhe në Naim Frashëri ndërsa me zgjerimin dhe rindërtimin e objektit të gjimnazit Kiril Pejçinoviç, do të rritet kapaciteti hapësor për zhvillimin e procesit edukativo arsimor për të gjithë nxënësit e kësaj shkolle.

Ndërtimi i terreneve sportive - ndërtimi i dy fushave të sportit në shkollën fillore “Kirili dhe Metodi” dhe në Gjimnazin “7 Marsi”



Ndërtim dhe furnizim me të gjitha pajisjet e nevojshme i studios së dizajnit në shkollën e mesme tekstile.

Në funksion të ngritjes së cilësisë së arsimit, Komuna e Tetovës rifilloi garat shkollore në të gjitha lëndët mësimore ndërsa nxënësit tanë arritën suksese kulmore në garat rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare, duke u kurorëzuar me 237 çmime të fituara deri në vitin shkollor 2016-2017, ndërsa nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme morrën pjesë në shumë projekte ndërkombëtare në kuadër të projektit evropian ERAZMUS+.



Komuna e Tetovës përgjatë viteve të kaluara është angazhuar në drejtim të mbrojtjes dhe afirmimit të trashëgimisë materiale dhe kulturore të Tetovës, si dhe theksimit të identitetit kulturor të qytetit me theks të veçantë në mbrojtjen e traditave, dokeve dhe zakoneve të banorëve të qytetit. Ne besojmë se ndërveprimi kulturor dhe shoqëror mes bashkësive të ndryshme etnike dhe religjioze që jetojnë dhe bashkëveprojnë në qytet, si dhe shfrytëzimi i artit si urë që lidh dhe bashkon, forcon identitetin dhe imazhin e qytetit tonë.



Nxitja dhe përkrahja e krijimtarisë artistike dhe jetës kulturore në qytetin tonë është bërë përmes shpërndarjes së mjeteve në bazë të aktvendimit për shpërndarjen e mjeteve për veprimtari kulturore, sipas Konkursit vjetor për përkrahjen e manifestimeve dhe aktiviteteve të OJQ-ve, artistëve vendas, dhe artistëve të rinj, përkrahjes profesionale, teknike apo ndihmës tjetër me kuadro dhe pajisje të cilat i posedon komuna të ngjarjeve kulturore të inicuar nga artist individual dhe shoqata kulturore organizimit të konkurseve letrare dhe pamore me qëllim nxitjen e krijimtarisë autentike, përkahje financiare për botimin e librave autoriale, me theks të veçantë tek të rinjtë dhe organizimin e festivaleve dhe manifestimeve të ndryshme kulturore.



Tetova gjatë katër viteve të fundit ka përjetuar rilindje të vertetë në kulturë dhe art. Gjatë periudhës së kaluar, më shumë se 120 artistë dhe shoqata kulturore të qytetit, janë pjesë aktive e jetës kulturore në komunën e Tetovës, ndërsa aktiviteti i tyre vazhdimisht ka pasur përkrahje institucionale. Manifestimet dhe festivalet tradicionale që organizohen nga komuna e Tetovës:

Vera e Kulturës Tetovare” - festival 2 javor ku përfaqësohen të gjitha format dhe gjinitë e artit dhe kulturës.





“Tetova Feston Nëntorin” manifestim disa ditore i cili lartëson tona vlerat kombëtare- foto prej defiles banda frymore

“Agjenda Kulturore DARDANIA” – organizime kulturore për të shënuar ditën e pavarësisë së Republikës së Kosovës

Manifestimet kulturore organizimi i të cilave përkrahet nga komuna e Tetovës :

Festivali i muzikës korale TEHO

Skena e Muzikës Serioze Shqiptare

Festivali i këngës qytetare TEUTA

Festivali ndërkombëtar i filmit TIFF ODA

Festivali ndërkombëtar i poezisë

DITËT E NAIMIT Java e Baletit, dhe shumë të tjera.

Komuna e Tetovës në vazhdimësi ka përkrahur iniciativat e të rinjve tetovarë përmes Programit për përkrahje të OJQ-ve aktive dhe përmes skemave tjera financiare. Me përkrahjen e komunës së Tetovës nxënësit e gjimnazit të Tetovës përgatitën dhe prezantuan dy projekte filmike; “Kohë që duhej të ishin jetë”, “Ftohtë midis jetës dhe vdekjes”



Komuna e Tetovës është angazhuar për revitalizimin e terreneve ekzistuese sportive, ndërtimin e sallave shkollore të sportit dhe ndërtimin e terreneve të reja sporti në zonat urbane dhe rurale. Pas transferit të kompetencave për menaxhim të objekteve sportive nga pushteti qendror, komuna e Tetovës nënshkroi marrëveshje për partneritet publik privat, sipas të cilës partneri privat do të kryejë

rindërtimin dhe rikonstruimin e Stadiumit të qytetit dhe ndërtimin e objektit përcjellës dhe terreneve të nevojshme sportive për tu arritur standardet UEFA dhe do të menaxhojë me këto objekte për 35 vite ndërsa pas kësaj periudhe këto objekte do t'i kthehen në pronësi komunës së Tetovës. Komuna e Tetovës aplikoi në programin HETRICK 4 në kuadër të së cilit u bë rikonstruimi i fushës së futbollit dhe u vendosën reflektorët në stadiumin e qytetit të Tetovës. Po ashtu në kuadër të programit HETRICK 3 u ndërtua stadiumi në qendrën sportive, u shtrua kullosa artificiale dhe u vendosën reflektorët. Vitin e parë të mandatit të ardhshëm do ta përgatisim dokumentacionin teknik dhe projektin për ndërtimin e pishinës me standarde olimpike dhe sallave të sportit në objektin te qendra sportive si dhe projektin për ndërtimin e fushave të reja të sportit të cilat do të vendosen në Programin vjetor të qeverisë për investime kapitale.

Gjatë këtyre viteve kemi organizuar, përkrahur dhe shtuar mundësitë për masivizimin e aktiviteteve sportive te të rinjtë tetovarë. Çdo vit shkollor me mijëra nxënës garojnë fillimisht në ligën komunale, më pas rajonale dhe ato republikane. Në vitin 2014 ishim nikoqir të Kampionatit të futbollit të klubit me famë botërore Arsenal, ku morrën pjesë futbollistë të vegjël nga 8 shtete të Europës Juglindore dhe ngjarje tjera sportive.

Organizuam turneun ndërkombëtar në karate “Tetova open”, turneun mbarëkombëtar në futboll të vogël “Tetova 2015”, garave në voleyboll me nxënësit e shkollave të mesme, në suazat e projektit “Shkolla të sigurt”, në bashkëpunim me MPB Tetovë dhe OSBE-në, kampingun e vrojtuesve në Tetovë te Guri i Sidollit Liqenet e Sharrit dhe Leshnicë ku vrojtues të rinj të klubeve vrojtuese nga rajoni, kanë përshkruar trajektore të këtyre viseve me ecje malore.



Tetova për fat të keq është një qytet i betonuar në mënyrë të pamëshirshme në të cilin rrallë gjenden hapësira të gjelbra por edhe hapësira publike të pa uzurpuara të cilat do të transformoheshin në parqe. Sidoqoftë kjo situatë nuk e minimizon nevojën për krijimin e



parqeve të reja në qytet të cilat po ashtu do të jenë të parashikuara në Planin e ri gjeneral urbanistik. Vitin e kaluar në hapësirën prej 9600 metra që gjendet përballë qendrës sportive u realizua projekti. Parku i Gruas i cili posedon rrjet për ndriçim LED, pajisje urbane për fëmijë dhe të rritur, 430 metra shteg për vrapim, 600 m për ecje dhe ka sistem për 24/7 video monitorim.

Po ashtu në realizim e sipër është projekti për rikonstrukcionin e rrugës së Banjës së qytetit ku nga gjatësia projektuar prej 2.3 km janë shtruar 1.5 km asfalt, janë ndërtuar trotualet dhe rrjeti i ndriçimit ndërsa ky lokacion parashihet të transformohet në Qark rekreimi me shtigje natyrore, zonë për aktivitete sportive, zona peshkimi dhe pika të caktuara për restorante dhe kafene.

MJEDISI I PASTËR JETËSOR

Mjedisi i pastër jetësor është një nga problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohet komuna e Tetovës krahas mungesës së ujit të pijshëm dhe ndotjes së ajrit veçanërisht gjatë periudhës së dimrit. Imazhet që i mbajmë në mend janë mbeturinat rreth e qark qytetit, djegia sistematike e tyre në deponinë e egër të qytetit dhe punëtorë të NPK që refuzonin të kryejnë punën e tyre sepse nuk ishin paguar nga ndërmarrja që ishte në falimentim e sipër.

Falë punës së ndërgjegjshme, NPK arriti të rimëkëmbet dhe t'i paguaj pesë rrogat e punëtorëve dhe 18 muaj kontribute të papaguara. Deri më 2013, kjo ndërmarrje ka menaxhuar grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave të qytetit me tre kamionë

vetanak dhe tre të marra me qira ndërsa sot kjo ndërmarrje posedon 25 kamionë me të cilat çdo ditë bëhet grumbullimi i mbeturinave nga zonat primare, një herë në javë nga zonat sekondare dhe dy herë në javë në vendbanimet rurale deri në fshatin Shipkovicë. Njëri nga prioritetet e NPK po ashtu ka qenë shpëtimi dhe rehabilitimi e sipërfaqeve të gjelbra ekzistuese. NPK gjatë këtyre viteve ka mirëmbajtur zonat e pakta të gjelbra të qytetit duke mbjellë mbi 4000 lule, drunjë dhe bimë tjera zbukuruese në gjithsej 26 lokacione të gjelbra në qytet nga të cilat 5 vende janë parqe në lagjet “Blloku 82”, “Blloku 70”, Rr. “170” dhe të tjerë, kurse, trotuaret janë pjesa e mbetur e qytetit në të cilët është bërë mbjellja e mbetur. Në këtë drejtim rregulluam parkun e Gruas përballë qendrës sportive dhe filluam rekonstruimin rrugës së Banjës së qytetit dhe rregullimit të rrjetit të energjisë elektrike i cili do të jetë një Qark rekreimi me shtigje natyrore, zonë për aktivitete sportive, zona peshkimi dhe pika të caktuara për restorante dhe kafene.



Pastrimi i shtretërve të lumenjve Shkumbin, Reçicë dhe Poroj bëhet çdo vit sipas Planit aksional të pastrimit të lumenjve të Ministrisë për ambient jetësor ndërsa këto lumenj arrijnë të qëndrojnë të pastra dy deri në tre muaj në vit. Pas vërshimeve të vitit 2015 dhe dëmtimit të infrastrukturës në zonat e vërshuara

të qytetit u rindërtuan pendët mbrojtëse në lumin Shkumbin ndërsa në këtë vit buxhetor është paraparë rregullimi i shtratit të lumit dhe ndërtimi i mureve mbrojtëse. Rregullimi i shtratit të lumit në Reçicë të madhe, me gjatësi prej 320m është kryer në gusht të vitit 2017 ndërsa janë përfunduar edhe ndërtimi i urës së re dhe riparimi i urës së vjetër në fshatin Poroj. Po ashtu sipas planit të UNDP pas vërshimeve të vitit 2015 do të rregullohet edhe shtrati i lumit në fshatin Poroj dhe muri mbrojtës në fshatin Xhermë.



Duke qenë se mjedisi i pastër jetësor është një përgjegjësi e përbashkët sociale, kemi organizuar një sërë aksionesh për pastrimin e lokacioneve të ndryshme të qytetit dhe fushata senzibilizuese për ngritje së vetëdijes qytetare për rëndësinë e sjelljes me përgjegjësi ndaj ambientit ku jetojmë sepse askund në botë nuk ka institucione efikase në mirëmbajtje të pastërtisë pa pasur qytetarë të përgjegjshëm dhe të vetëdijshëm për rolin e tyre në ruajtjen e mjedisit të pastër dhe të shëndetshëm.



‘21 Marsi’ Dita nderkombëtare e ekologjisë - 21 Mars 2016



Aksioni ekologjik ‘Të pastrojmë Tetovën’ - 2015



“Ta pastrojmë Tetovën” - aksioni i pastrimit të varrezave myslimane



Faza e parë e aksionit: Ta pastrojmë Tetovën - 2014



Aksion për pastrimin e Sh.F Liria dhe Kirili dhe Metodi - 2014



Aksioni për pastrimin e Banjës së Tetovës - 2014



Mbjellja e drunjëve në Banjën e Tetovës - 2013



Aksion i pastrimit të hapësirës së komunës së Tetovës -2013

Nga viti 2013 duke marrë parasysh urgjencën e problemit të deponisë së egër komuna e Tetovës ka bërë kërkesë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë t'i ndaj mjetet e nevojshme për pastrimin e deponisë së egër të qytetit si problem prioritar për tu zgjidhur. Për këtë qëllim Qeveria miratoi 12 milion denarë në muajin gusht dhe dy ditë pas miratimit të tyre deponia u pastrua tërësisht. Në vitin 2016 komuna e Tetovës ka miratuar PDU për bllokun urban 58 ku përfshihet edhe lokacioni ku gjendej deponia e egër e qytetit ndërsa sipas këtij plani ky lokacion do të jetë i destinuar për objekte komerciale.



Po ashtu këtë vit do të fillojë ndërtimi i stacionit për ngarkim-shkarkim të mbeturinave në Falishtë – Komuna e Tetovës. Me anë të DUPL-së është paraparë ndërtimi i dy objekteve – edhe atë impiantit e trajtimit të ujërave të zeza dhe një stacion për deponimin e mbetjeve komunale me infrastrukturë adekuate ku do të bëhet edhe selektimi sekondar i mbeturinave. Ndërtesa e projektuar përfaqëson një sallë me lartësi prej 9.53 m dhe me dimensione prej 77.95 x 21.25m ndërsa objekti paraqet një stacion transferimi për mbeturinat e përziera komunale për nevojat e NPK – së në Tetovë i cili do të grumbullojë sasinë prej 50 ton

në ditë. Si zgjedhje e përkohshme deri në ndërtimin e stacionit për ngarkim-shkarkim në këtë lokacion janë vendosur kontejner mobil ku bëhet shkarkimi i mbeturinave dhe organizohet bartja e tyre deri në deponinë Rusino. Në buxhetin e vitit 2018 është paraparë rindërtimi i rrugës prej urës në Banjicën e poshtme deri në deponinë në gjatësi prej 6 km për të siguruar standardet minimale të funksionimit të deponisë.



Me qëllim të gjetjes të zgjedhjes së qëndrueshme të menaxhimit të mbeturinave në nivel rajonal Qendra për zhvillimin e rajonit të Pollogut aplikoi me Projektin për përmirësimin e menaxhimit me mbeturinat në rajonin e Pollogut dhe fitoi donacion në vlerën prej 7,920,000.00 franga zvicerane nga Sekretariati shtetëror për çështje ekonomike i Zvicrës (SECO), i përfaqësuar nga Ambasada e Zvicrës në Republikën e Maqedonisë. Ky projekt do të realizohet në dy faza:

Me qëllim të gjetjes të zgjedhjes së qëndrueshme të menaxhimit të mbeturinave në nivel rajonal Qendra për zhvillimin e rajonit të Pollogut aplikoi me Projektin për përmirësimin e menaxhimit me mbeturinat në rajonin e Pollogut dhe fitoi donacion në vlerën prej 7,920,000.00 franga zvicerane nga Sekretariati shtetëror

për çështje ekonomike i Zvicrës (SECO), i përfaqësuar nga Ambasada e Zvicrës në Republikën e Maqedonisë. Ky projekt do të realizohet në dy faza:

- Me qëllim të gjetjes të zgjedhjes së qëndrueshme të menaxhimit të mbeturinave në nivel rajonal Qendra për zhvillimin e rajonit të Pollogut aplikoi me Projektin për përmirësimin e menaxhimit me mbeturinat në rajonin e Pollogut dhe fitoi donacion në vlerën prej 7,920,000.00 franga zvicerane nga Sekretariati shtetëror për çështje ekonomike i Zvicrës (SECO), i përfaqësuar nga Ambasada e Zvicrës në Republikën e Maqedonisë. Ky projekt do të realizohet në dy faza:
- Mbrojtja e ajrit ambiental - sipas studimeve të Ministrisë për mjedis jetësor dhe instituteve të pavarura, ndotës kryesor të ajrit ambiental në komunën e Tetovës janë industritë, komunikacioni dhe ngrohja me dru në periudhën e dimrit. Për këtë arsye komuna planifikon funksionalizimin e ndërmarrjes së themeluar për transport publik për të siguruar qytetin me linja të rregullta për transport publik, gazifikimin e qytetit me çka do të mundësohet ngrohje me gaz, ndërtimin e qarkores Trebosh - Neproshten me qëllim të dekoncentrimit të qarkullimit të automjeteve neper qytet dhe kontrollin e rreptë ndaj ndërmarrjeve të mesme për zbatimin e standardeve ekologjike.
- Mbrojtja e ujit- me zëvendësimin e gypave ekzistues nga azbesti i çimentuar të rrjetit të ujësjellësit të qytetit me material të polietilenit do të sigurohet cilësia e lartë e ujit të pijshëm
- Mbrojtja e tokës- me anë të ndërtimit të rrjetit të kanalizimit, kolektorëve dhe impiantit për trajtim të ujërave të zeza do të largohen gropat septike në tokë

MBROJTJA SOCIALE

Komuna e Tetovës përveç aktiviteteve të ndërmarra në korniza të kompetencave ligjore është angazhuar në forma të ndryshme në drejtim të përkujdesjes sociale ndaj gjitha kategorive të qytetarëve të saj.

Disa ndër kategoritë në të cilat Komuna e Tetovës është angazhuar janë

- Përkujdesje për familjet në nevojë

Gjatë katër viteve të kaluara, Komuna e Tetovës ka ndarë vlere të konsiderueshme të mjeteve financiare për qytetaret me qëllim të mbështetjes së tyre në nevojat e

tyre shëndetësore, sociale apo ndihmës për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.

Gjithashtu, Komuna e Tetovës përmes kuzhinës popullore në kuadër të çerdhes së qytetit përgatit 100 shujta në ditë për familjet skamnore.

- Përkujdesje për personat me aftësi të kufizuara

Përmirësimi dhe avancimi i kushteve socio-ekonomike të personave me aftësi të kufizuar ka qenë prioritet i komunës sonë në këto katër vitet e fundit. Në vijë me këtë ide, Komuna e Tetovës në bashkëpunim me Shoqatën e psikologëve shqiptarë në Maqedoni realizoi me sukses projektin “Mbështetje për fëmijët me autizëm dhe përmirësimi i jetës së tyre të përditshme”. Në këtë projekt u angazhuan 14 psikolog, të cilët punuan me fëmijë të diagnostikuar si autik dhe të regjistruar në qendrën e shoqatës së psikologëve në Tetovë.

Në bashkëpunim me UNDP-në, Ministrinë për punë dhe mirëqenie sociale dhe Agjensionin për punësim, Komuna e Tetovës këtë vit fillon me projektin “Asistent edukativ në arsimin inkluziv” i cili parasheh punësimin e 15 psikologëve në shkolla fillore, të cilët do të angazhohen në mbështetjen dhe përmirësimin e jetës së 15 nxënësve me aftësi të kufizuara të përfshirë në arsimin inkluziv.

Në bashkëpunim me Ambasadën e Gjermanisë është bërë rikonstruimi i klasës speciale dhe pajisjes së saj me mjetet e nevojshme për nxënësit me aftësi të kufizuara në SH.F. Kikish. Gjithashtu, me ndihmën e Ambasadës Çeke u bë rikonstruimi i klasës speciale në SH.F. Liria.

- Përkujdesje për grupet e marginalizuara

Komuna e Tetovës në bashkëpunim me Këshillin e Evropës dhe OJQ Sonce realizoi projektin “Romed 2” për socializimin e komunitetit rom.

Gjithashtu, përmes programit “Punë e dobishme komunale” e mbështetur nga UNDP, Komuna e Tetovës në bashkëpunim me organizatën joqeveritare “Forumi i gruas” dhe “Sonce” realizoi një sërë aktiviteteve me qëllim të zbutjes së papunësisë për grupet që kanë më tepër vështirësi të kyçen në tregun e punës, dhe të njëjtëve t’ju mundësohet avancim të aftësive punuese, ngritje të vetëbesimit se janë të aftë për tregun e punës, etj. Në kuadër të projektit, 25 gra që kanë qenë viktimë potenciale të dhunës në familje, ndoqën ligjërata informative, ndërsa 10 persona u angazhuan për gjashtë muaj përmes këtij projekti duke ofruar kujdes, përkrahje, ndihme dhe shërbime për 25 persona të komunitetit rom.

- Përkujdesje për fëmijët parashkollorë

Në kuadër të projektit të UNICEF “Pesë të parat, të mbarat” janë themeluar qendrat për zhvillim të hershëm të fëmijëve në Shipkovicë, lagjen Teteks, Sellcë, Reçicë dhe Falisht ndërsa nga ky vit funksionojnë edhe qendrat në Xhepçisht-Poroj, Brodec dhe Gajre. Po ashtu objektet e çerdheve ekzistuese janë rinovuar. Në çerdhen “Rinia – objekti Qendra sportive” u ndërruan dyert, dritaret, fasada e brendshme dhe inventari ndërsa rikonstruim i pjesshëm u bë edhe në çerdhen Potok, Qendër dhe Teteks, si dhe u rindërtua kulmi në çerdhen e vjetër të qytetit. Vitin e parë të mandatit të ardhshëm do të ndërtohet çerdhe e re për fëmijë në hapësirën e shkollës fillore Kiril dhe Metodi e cili sipas PDU është paraparë t’i shërbejë këtij qëllimi.









Në lidhje me shërbimet sociale, komuna do të shfrytëzojë të gjitha kapacitetet e saj në

- Sigurimin e burime të jashtme plotësuese të mjeteve financiare për implementimin e projekteve për mbrojtje sociale.
- Aplikimi me projekte të lëmisë mbrojtjes sociale në programet e organizatave ndërkombëtare
- Planifikimin i sistemit të shërbimeve vullnetare, krijimi i grupeve vullnetare për t'ju shërbyer qytetarëve në nevojë.
- Hapjen e çerdheve të reja
- Hapja e qendrës për fëmijë autik.



www.bdi.mk